

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deonitarsko Društvo

Nr. 7154 Data. 29.11.2022
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



RREGULLORE Për Ndryshimin dhe PLOTËSIM TË RREGULLORES NR. 734 të datës 11.02.2021 për procedurat e avancave dhe shpenzimeve me paranë e imët (petty-cash) dhe avancat për udhëtime zyrtare

Mitrovicë, më 25.11.2022



Në bazë të nenit 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 3 paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, Ligjit NR. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 20 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 8 të Statutit të Trepça Sh.A, Bordi i Mbikëqyrës i Trepça Sh.A., në mbledhjen e mbajtur më 25.11.2022, miraton këtë:

Neni 1

Me këtë rregullore bëhet Plotësimi - Ndryshimi i Rregullorës Nr. 734 të datës 11.02.2021 për procedurat e avancave dhe shpenzimeve me paranë e imët (petty-cash) dhe avancat për udhëtime zyrtare.

Neni 2

Neni 5 i rregullores bazike paragrafi 1 riformulohet si në vijim:
Paratë e imëta – janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesje dhe nën kontrollin e Zyrtarit Kryesor Financiar të Trepça Sh.A., dhe Njësive Biznesore iu ndahet vlera mujore:

Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Trepça Stantërg i ndahet vlera deri 3,000 €
Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë i ndahet vlera deri 2,000 €
Njësia Biznesore Fabrika e Paisjeve të Procesit i ndahet vlera deri 300 €
Njësia Biznesore Industria Kimike i ndahet vlera deri 300 €
Njësia Biznesore Fabrika e Akumulatorëve (Terminale Doganor) i ndahet vlera deri 300 €
Njësia Biznesore Metalurgjia e Zinkut i ndahet vlera deri 100 €
Stabilimentet energjetike (Energjetika) i ndahet vlera deri 100 €

Neni 3

Tërheqja e parave të tjera do të behet pas rimbursimit të muajit paraprak.

Neni 4

Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore për plotësim ndryshimin për procedurat e avancave dhe shpenzimeve me paranë e imët (petty-cash) dhe avangat për udhëtime zyrtare, hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe fillon të aplikohet prej ditës së publikimit në web-faqen zyrtare.

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A


Dr.Sc. Bahri Hyseni

